Mal Berisha

"Dear Kosovar Guests!"

Welcome to America

Kujtime nga Baza Ushtarake Amerikane Fort Dix, New Jersey

Pranvera e Vitit 1999

REPORTAZH NGA BAZA USHTARAKE AMERIKANE FORT DIX, NEW JERSEY

Me të Shpëtuarit Shqiptarë të Kosovës – Pranvera e Vitit 1999

Nga Mal Berisha

Epilog

Në pranverën e vitit 1999, baza ushtarake amerikane Fort Dix në New Jersey u shndërrua në strehën më të madhe të shpresës për mijëra shqiptarë të Kosovës që u dëbuan me dhunë nga atdheu i tyre. Brenda pak orësh udhëtimi, ata kaluan nga tmerri në përkujdesje njerëzore si në asnjë vend tjetër.

Më 24 mars 1999, forcat ajrore të NATO-s filluan bombardimet mbi caqet ushtarake të Sllobodan Milosheviçit. Avionët u nisën nga baza ushtarake e Avianos dhe skuqën qiellin e mugët të asaj që kishte mbetur nga Jugosllavia.

Si reagim ndaj bombardimeve të NATO-s, veprimet e kriminelëve serbë të Milosheviçit në tokën e Kosovës u intensifikuan në formën më agresive të parë ndonjëherë: deportime masive, shfarosje të popullsisë, djegie të banesave dhe pasurisë, përdhunime dhe keqtrajtime, të cilat shkaktuan një shqetësim të jashtëzakonshëm ndërkombëtar.

Të parët që reaguan ishin amerikanët, të cilët caktuan bazën ushtarake të Fort Dixit, në shtetin e New Jersey-t, si

një vend ku do të strehoheshin mijëra shqiptarë të Kosovës, të transportuar me mjete ajrore dhe prej aty të shpërndaheshin në të gjithë Shtetet e Bashkuara.

I

ISHA ACTIVIST I LIGËS QYTETARE SHQIPTARO AMERIKANE

I përfshirë në grupin e punonjësve humanitarë amerikanë dhe të emigracionit, pata rastin të pres grupin e parë të shqiptarëve të Kosovës që zbritën në aeroportin ushtarak Fort Dix, në jug të shtetit të New Jersey-t. Ishin ditët e para të prillit 1999 kur u mblodhëm në atë bazë. Shumica ishin amerikanë: ushtarakë, punonjës të agjencisë së Emigracionit, agjencive humanitare, shërbimeve të tjera… si dhe disa shqiptaro-amerikanë me qëndrim të ligjshëm në SHBA. Unë përfaqësoja Ligën Qytetare Shqiptaro-Amerikane, të drejtuar nga ish-kongresmeni Joe DioGuardi.

Avioni i parë ushtarak që mbërriti, plot e përplot me shqiptarë të Kosovës, u ul rëndë-rëndë, dhe mua më dukej sikur mbante mbi krahë tërë peshën e dheut të tyre të boshatisur nga dhuna. Vërtet ishte shumë i madh, por ngjyra e tij kaki-ushtarake, ngarkesa njerëzore që kishte me vete dhe padurimi ynë për t'i parë, për t'i takuar e për t'i ndihmuar, e bënin të dukej më i rëndë se vetë pesha e tij fizike. Aty prisnin mbi 100 kamera televizive të qendrave më të mëdha të informacionit në botë.

Nuk vonoi dhe nga dera e avionit filluan të zbrisnin udhëtarët e parë. Mendimi i parë që na kaloi nëpër kokë ishte:

Vallë, a do të mund të zbresin dot nga shkallët? A janë aq të qëndrueshëm sa të arrijnë deri te qilimi i kuq, i shtruar nga autoritetet shtetërore të New Jersey-t, të cilët kishin vënë gjithçka në dispozicion të tyre?

Ata po zbrisnin, dhe unë ndjeja sikur çdo shkallë e mëposhtme që shkelte këmbë e tyre, ishte si një gong që shënonte rënien numerike të popullsisë së Kosovës. Një, dy, tre, katër, dhjetë, njëqind, katërqind e pesëdhjetë vetë zbresin me hapa të rëndë, të lodhur, të dërrmuar...

Katërqind e pesëdhjetë shqiptarë më pak në dheun e tyre, vetëm nga ky aeroplan... Po sa mijëra të tjerë kishin ikur në drejtime të tjera, nëpër gjithë botën, deri në Australi e Zelandën e Re?

Autobusët e kompanisë më të madhe amerikane të transportit tokësor të udhëtarëve, *Academy*, ishin reshtuar fare pranë pistës. Ndoshta ishte hera e parë që atyre u lejohej hyrja në atë bazë ushtarake. “Musafirët” u ngjitën në autobusë, të cilët kishin ulur krikët e shasisë deri në nivelin e tokës, për t’ua lehtësuar sadopak përpjekjen fizike për t’u ngjitur në shkallët e automjetit.

Karvani i autobusëve i transportoi ata njerëz, fytyrat e të cilëve ngjanin më shumë me portrete filmash me legjenda e personazhe mitikë, sesa me njerëz realë. Dikush e kishte quajtur udhëtimin e tyre “biblik”. Dhe vërtet, i tillë ishte. As në Bibël dhuna nuk i ka ndjekur njerëzit kaq larg!

Në sallën e madhe të gjimnastikës së bazës ushtarake ndodheshin shërbime nga më të ndryshmet: sanitare, shëndetësore, ushqimore, pije freskuese pa fund, kafe,

dekafe, çaj, fruta të çdo lloji, sanduiçë pa mish derri; infermierë, mjekë, punonjës socialë, përfaqësues të Kryqit të Kuq, vullnetarë, punonjës emigracioni, përkthyes të gjuhës shqipe, civilë, ushtarakë, agjentë të FBI-së, dhe shumë të tjerë – të njohur e të panjohur.

Secili mbante në qafë një kartë identifikimi dhe, në mënyrën më njerëzore të mundshme, kujdesej për diçka. Edhe unë mbaja një të tillë, bashkë me djalin tim. E gjithë kjo përkushtohej vetëm për ata njerëz.

Salla u mbush. Njerëzit zunë vend nëpër shkallët e gjimnazit. Ishin jashtëzakonisht të lodhur, të nxirë nga dielli, dhe kundërmonin nga rruga e gjatë dhe kushtet e tmerrshme në të cilat kishin kaluar ditët dhe javët e fundit të jetës së tyre deri aty.

Një pjesë e atyre që nuk mund të rezistonin më u shtruan mbi fushën e sportit, nëpër barrela ushtarake, dhe filluan të merrnin serume. Nga altoparlanti dëgjoheshin thirrjet e pandërprera të punonjësve socialë: "Ju lutemi shumë, merrni sa më shumë lëngje! Pini lëngje, sepse trupat tuaj janë të dehidruar!" Një përkujdesje kaq njerëzore as që do ta kisha imagjinuar. Merrej me mend se çfarë kontrasti i jashtëzakonshëm ishte për ata njerëz: ky kalim sublimues nga gjendja e tmerrshme që kishin lënë pas, tek kjo që i priste këtu.

II

PRITJA E UDHËTARËVE "BIBLIKË"

Udhëtimi biblik? A ishte vërtet i tillë? Ndoshta ishte edhe më biblik se ç'e kishin përshkruar oratorët. Në mos

për tjetër, ishte udhëtimi më i gjatë që njerëzimi kishte provuar ndonjëherë, në ikje e sipër nga një makinë vrastare.

Filluan procedurat e para. Tani secili kishte zënë vendin e vet. Në sallë u shfaqën përballë: Zonja e Parë e Amerikës, Hillary Clinton; Guvernatorja e shtetit të New Jersey-t, zonja Christine Todd Whitman; Sekretarja e Shtetit për Shëndetësinë dhe Shërbimet Sociale; kongresmenë, senatorë, si dhe autoritete lokale të bazës ushtarake Fort Dix.

Salla shpërtheu në duartrokitje. Ato dukeshin të buta, pak të shurdhëta, si një daulle e shfryrë, si një def i panxehur. Në to më dukej se dëgjoja diçka që nuk dëgjohet, më dukej se ndjeja atë që nuk ndjehet. Të rrahurat e atyre duartrokitjeve kishin pak zë, por tingëllonin shumë.

Dukej sikur ishin të akorduara në frekuenca që nuk dëgjohen afër. Sikur secili donte të bënte zhurmën e tij – jo për vete, jo për atë që shihej, as për atë që ndjehej. Duket se ata donin që ato duartrokitje të shkonin përtej atyre mureve, përtej atij pylli që rrethonte ndërtesën – tutje, larg, diku ku ato mund të dëgjoheshin jo më për ata vetë, por për ata që kishin lënë prapa.

Duartrokitjet duhej të tërhiqnin vëmendjen për ata që ndodheshin në male, të mbetur rrugëve, pa ushqim e pa veshmbathje – për ata që ishin në mëshirë… të kujt? Ndoshta, në rastin më të mirë, në mëshirën e askujt! Sa mirë do të ishte që ata që ndodheshin atje, nëpër pyje, të ishin të paktën në mëshirën e askujt…?!

Dhe ai gëzim i venitur i atyre njerëzve – që nuk dinin më as të gëzoheshin, as të hidhëroheshin – ishte tashmë hedhur mbi atë sallë si një vello, ngjyrën e së cilës askush nuk

mund ta përcaktojë: e bardhë, e zezë, blu… apo ndoshta më së miri – flu; e paqartë, e pashkëlqim, e shlyer.
Mbaroi edhe ceremonia. U tha se ju jeni njerëzit më të fortë në botë, se keni në krah Amerikën – që kurrë nuk do t'ju lërë në baltë, se do të bëhet gjithçka për ju dhe bashkëkombasit tuaj – dhe plot e plot të tjera…
Tani do të niste procedura e parë, ajo më elementarja: marrja e identitetit të këtyre njerëzve, shumica e të cilëve nuk kishin asnjë dokument identifikimi, për arsye të ndryshme – ndër të cilat më kryesorja ishte se ato u ishin grisur nga autoritetet policore serbe, me qëllim dëbimin e tyre, madje edhe pa lënë gjurmë të emrit.

III

TË SHOHËSH JO NJË SHFAQJE TË TRAGJEDISË, POR VETË TRAGJEDINË E LUAJTUR NGA TRAGJIKËT

Në rastet kur mungonte çdo dëshmi identiteti, çështja kalonte nëpër një seancë marrjeje në pyetje. Ishte një procedurë e thjeshtë, por ndër më të vlefshmet për të kuptuar gjithçka që kishte ndodhur në atë vend – në Kosovë.

Aty mësoje shumë për thellësinë e tragjedisë dhe të vuajtjes njerëzore. Mësoje se si fëmija kishte parë prindërit teksa vriteshin, se si prindi kishte parë fëmijën po ashtu. Mësoje se njeriu nuk arrinte të ndihmonte as njeriun e vet në çastet më të vështira të jetës – sepse as këtë nuk ia lejonin.

Aty kuptoje sa e vyer është jeta kur e jeton në një vend të sigurt, po aq sa mësoje se sa e pavlefshme bëhet ajo në çaste të caktuara. Mësoje se si njeriu është gati t'i japë fund jetës në çdo çast, ndërkohë që lufton për ta mbrojtur atë me këmbë e me dhëmbë.

Këtu njeriu nuk sheh figura të krijuara në laboratore krijuese, që interpretojnë tragjedinë njerëzore — por sheh vetë tragjedinë. Sheh vetë atë realitet që dikush tjetër përpiqet ta rikrijojë përmes skenave tronditëse e mesazheve emocionale.

Jo, në këtë vend nuk ka nevojë për lojëra aktorësh Këtu secili është aktori origjinal i një tragjedie njerëzore, e shkaktuar mbi të thjesht për faktin se rasti bëri që ai të lindte me një fe, një besim dhe një komb të caktuar.

Pfu!

"Tjetri, kush është tjetri në radhë?" – thërrisnin oficerët e emigracionit.

Nga ajo datë e deri më 10 qershor 1999, baza ushtarake e shtetit të New Jersey-t, Fort Dix, priti 6.500 shqiptarë të Kosovës. Është e pabesueshme, por e vërtetë: jam takuar dhe kam njohur, përmes lidhjeve të ndryshme në Kosovë, me pothuajse të gjashtë mijë e pesëqind prej tyre. Me shumë prej tyre kam ende lidhje dhe e ruajmë miqësinë e lindur në ato ditë të jashtëzakonshme.

IV

SHEHRIJA E VOGËL NGA DRENASI

Ndërsa u shërbenim shqiptarëve të ardhur nga Kosova në bazën ushtarake Fort Dix, në New Jersey, më rastisi të takoja edhe një vajzë me emrin Shehrije. Ajo ishte 15 vjeç, me një fytyrë engjëllore të rryer nga lodhja, me sy të thellë e të frikësuar, me një buzëqeshje të shtrënguar, me flokë të shpupurisur e të pakrehur – shenjë e një pakujdesie të gjatë dhe të pashmangshme.

Ajo erdhi ngadalë, e ndrojtur, dhe u ul në karrigen e intervistës, përballë oficerit të emigracionit.

– Si ndjehesh? – e pyeti oficeri.

– Mirë, – u përgjigj ajo, por mua më dukej se në atë fjalë mungonte zanorja “i”.

– Heh... si të them... mirë, – shtoi ajo.

– Ke nevojë të pish diçka? – e pyeti oficeri me zemërmirësi.

– Jo, sapo piva.

– A je në gjendje të flasësh?

– Po, – tha ajo. Por edhe tek kjo fjalë më dukej se mungonte zanorja “o”.

– A mund të fillojmë? – pyeti ai përsëri.

– Po, – përsëriti ajo.

Por në atë çast, ajo u ngashërye. U ngashërye aq shumë, sa u ngjesh pas meje, më vuri duart rreth qafës dhe, me dënesa e lot, më pushtoi… dhe nuk më shqitej më.

Dënesi, dënesi... qau, lotoi. Qava dhe unë. Lotova. Ndjeva se kisha aq shumë nevojë... Po shkarkoja diçka nga shpirti im. U përpoqa ta qetësoja – sado që tani kisha nevojë vetë të qetësohesha. Por unë duhej ta qetësoja atë. Sigurisht.

Po mua, kush do të më qetësonte?!

Kaluan disa minuta. Ajo u përmend. Fshiu lotët me një pecetë letre që gjendej në tavolinën e punës së oficerit. U përpoqa të thaja lotët e mi dhe t'i kthehesha punës, për t'ia përcjellë atij oficeri tërë dramën e kësaj qenieje të brishtë. Pashë se edhe ai kishte nevojë për dikë që ta qetësonte.
Pas pak filluam:
Emri: Shehrije
Mbiemri: Bajrami
Emri i nënës: … Një ofshamë e thellë, e ngrohtë, e pjekur… një zë që sillte me vete vuajtjen e hershme të kësaj fëmije u kthye në fjalë:
– Nëna ime quhej…
Emri i babait?
Një ofshamë tjetër, e thellë, doli nga shpirti i saj bashkë me fjalët:
– Babai im quhej...
– Përse thua *quheshin*? – pyeti oficeri.
– Sepse ata nuk jetojnë më.
– Asnjëri?
– Jo, asnjëri.
– Si ndodhi?
– Nëna më vdiq kur isha e vogël. Nuk e mbaj mend fare. Më rriti një nënë tjetër – gruaja e dytë e babait tim. Më ka dashur si fëmijën e vet… dhe ndoshta, për këtë arsye, nuk më la ta ndjej aq shumë mungesën e nënës sime.
Babai kishte ardhur në Amerikë kur unë isha e vogël. Punoi në një shtet që quhet Ohio. Atje arriti të bëjë ca para dhe mori edhe shtetësinë amerikane. Pas disa vitesh, ai u kthye në vendlindje. Aty hapi një biznes të vogël dhe ndërtoi një shtëpi të bukur.

Me njerkën time pati katër fëmijë – dy djem dhe dy vajza. Të gjithë si drita!

Babi nuk merrej me politikë, por e shihja se ndihmonte shkollën private që mbahej në shtëpinë e njërit prej fqinjëve tanë, pasi shkollat publike ishin mbyllur nga serbët. Aty dërgonte para, rroba, lodra, fletore, libra, lapsa dhe mjete të tjera shkollore.

Policia na përzinte shpesh nga shtëpitë-klasa dhe na i rrihte mësuesit përpara syve tanë. Babi i strehonte nxënësit dhe mësuesit.

Aty nga vjeshta e vitit të kaluar u tha se do të vinin disa verifikatorë. Kështu na thanë neve: se do të vendoseshin nëpër gjithë qytetet e Kosovës dhe do të raportonin për situatën.

Por ata duhej të qëndronin diku. Dhe babi im shkoi dhe u tha:

– Merreni shtëpinë time. Është e mirë dhe mund ta përdorni sa kohë që jeni këtu. Mjafton që të raportoni atë që po ndodh me ne.

Babi kishte jetuar në Amerikë dhe shumë gjëra i kuptonte, ndoshta, më mirë se shumëkush. Verifikatorët erdhën dhe u vendosën te ne. Ata mbanin disa shenja në rroba dhe në makinë – më duket se shkruhej OSCE. Ne i deshëm shumë.

Babai bënte gjithçka që ata të ndiheshin mirë. Nuk u kërkonte qira, u shërbente për gjithçka që kishin nevojë. Qëndruan tek ne deri pak para bombardimeve – më duket, dy ditë përpara. Erdhi një urdhër… dhe ata u larguan.

Ne u ndjemë krejtësisht të vetmuar. Ata nuk kishin armë, por na dukej sikur na mbronin. Nuk ishin aty për të luftuar, por ndjenim se dikush, të paktën, po shihte e do të

dëshmonte atë që do të ndodhte me ne. Dhe ndiheshim, gjithsesi, pak më të sigurt.
Tani? Tani ata kishin ikur. Dhe ne ishim në mëshirën e… kujt?
Jo. Të askujt.
As të fatit.
Nuk e di… të kujt.

Nuk zgjati shumë… dhe filluan bombardimet. Bashkë me to, edhe dëbimi, vrasjet, shfarosja.
Dhe e dini nga e nisën? Nga ata që kishin strehuar verifikuesit.
Ne ishim prej atyre.
Me të kërcitur bomba e parë, në mëngjesin e ditës tjetër, erdhën ata – serbët.
Ishte një togë njerëzish…
O Zot!
Të ashpër, të egër, të armatosur, të dehur… që bërtisnin, klithnin, shanin.
Në shtëpi ishim të gjithë: babai, njerka, katër vëllezërit dhe motrat e mia nga babai… dhe unë.
Na nxorën në oborrin e shtëpisë. Na rreshtuan përballë murit.
Pastaj e ndanë babain prej nesh.
I thanë të lëvizte pesë hapa anash.
Në fillim hezitoi. Por pastaj lëvizi.
Siç dukej, e ndjeu se pranë nesh do të ndante vetëm vdekjen, jo mbijetesën.
Hodhi hapat. U kthye nga ne.
Na pa një nga një... të gjithëve.
Dhe, me zërin që e dëgjonim sa herë na përqafonte, tha në anglisht:

“I love you all. I love you.”

Në një moment, një breshëri automatiku u zbraz mbi trupin e tij.

Ndoshta e kishte ende shikimin drejt meje dhe në gojë fjalën “lo…ve”.

“Love”, për herë të tretë… kur iu këput zëri dhe u rrëzua përtokë.

Vrapova drejt tij. U hodha sipër duke bërtitur:

– Jooooooo! Jo! Jo!

Por një dorë e fuqishme më kapi për krahu – një ganxhe që më ngriti përpjetë me aq forcë, sa m’u duk se isha një pendël në ajër. Ndjeva këmbët që nuk më preknin më në tokë.

E kisha humbur peshën në duart e një bishe që sakaq më fluturoi në një cep të oborrit. Një tjetër breshëri u zbraz. Dhe nga një grykë bishash, më shumë se nga goja e një njeriu, u dëgjua një klithmë barbare:

– Berzhi! Berxhi!

Shtëpia kishte dy porta. Të dyja të hapura. Dëgjoheshin automatikë që zbrazeshin.

Babi kishte mbetur i shtrirë përtokë.

Të tjerët po largoheshin në panik.

Unë dhe njerka, bashkë me dy motrat, morëm të njëjtin drejtim. Vëllezërit – drejtim tjetër. Nuk e di ku shkuan.

Ne ia dolëm të kalojmë në Maqedoni.

U paraqitëm në Konsullatën – çadër të Amerikës…

…dhe ja ku jemi!

Ishim dy vetë – oficeri i emigracionit dhe unë – që kishim mbetur të shtangur. Çfarë force kishte ai fëmijë për të treguar atë që kishte parë me babanë e vet, kur ne nuk kishim forcë as për ta dëgjuar?

Vërtet forcohet aq shumë njeriu?

V

I NGJAJA BABAIT TË SHEHRIJES

Ditën tjetër, Shehrija më pa pranë dyqanit të zyrave tw Kryqit të Kuq. Ajo erdhi me vrap, si një manare, dhe më përqafoi.

Ndjeva dhimbjen dhe dashurinë që ndjen çdo prind. Por kur u shkëput për të më dhënë dorën, po qante me dënesë.

U përpoqa ta qetësoja. I afrova diçka për të pirë… dhe iku.

Ky ritual u përsërit për disa ditë me radhë, derisa një ditë, motra e saj nga babai më tha:

– A e di ti përse Shehrija qan sa herë që të sheh?

Në të vërtetë, diçka duhej ta kisha marrë me mend. Por megjithatë, i thashë:

– Ma thuaj ti, të lutem...

– Sepse ti i ngjan krejtësisht babait tonë, – u përgjigj vogëlushja.

VI

NË DRENAS – KOSOVË

Ishte ajo përgjigje e asaj vajze që më solli sot këtu, në Drenas, te shtëpia e familjes Bajrami. Këtu janë rrënojat e asaj që dikur duhet të ketë qenë një shtëpi shumë e bukur, tipike e një shqiptari të Kosovës:

oborri i gjerë, kanatat e një dere të madhe, nëpër të cilën mund të kalonin makina të rënda; ballkone të stolisura me ornamente dhe kollonada të shkurtëra.

Kjo shtëpi më solli ndër mend kujtimet e Fort Dix-it, bazës ushtarake amerikane në New Jersey, ku u njoha me një nga tragjeditë më të mëdha që kanë përjetuar shqiptarët e Kosovës – në marsin e vitit 1999.
Unë i ngjaja babait të Shehrijes.
Ndërsa Shehrija mbarte mbi supe tërë peshën e asaj tragjedie… që e përjetoi Kosova jonë.

VII

KOSOVA – KËNGA E KËNGËS: DY FAQE NGA DITARI I FORT DIX

Shpresa, një vajzë e vogël nga Ferizaj, përfaqësonte qindra fëmijë që kishin humbur gjithçka, por ruanin në zemrë vjersha për flamurin dhe Kosovën. Ajo nuk e quante veten "refugjate", por "mysafire" – për ta ruajtur dinjitetin.

Administrata amerikane, në krye me Zonjën e Parë dhe me Ministrinë e Shërimeve Humane, krijoi kushte të jashtëzakonshme jetese. Çdo aspekt – ushqimi, shëndeti, arsimimi, argetimi, kontaktet me të afërmit – ishte trajtuar me përkushtim të rrallë. Kudo ndihej prania e fjalës "mik" në vend të "refugjat".

Shefqet Bejta nga Obiliqi, i cili kishte tre djem në UÇK, tregonte jetën e tij në arrati dhe rrëfimin e së kaluarës që ishte shkatërruar me buldozer nga pushtuesit. Gervallajt, të përfaqësuar nga Zeqiri, ruanin në kujtesë historinë e dhimbshme të kombit, por edhe shpresën që Kosova tashmë ishte në krah të qytetërimit.

Enver Berisha, intelektual dhe trajner futbolli, rrëfente se pa Kosovën ai ndihej vetëm. "Kosova është gjaku ynë që nuk falet," thoshte ai, ndërsa përjetonte transmetimin e ndeshjes së parë në stadiumin e Prishtinës pas luftës.

Kapiteni James McCarthy nga ushtria amerikane, i prekur thellë nga ndryshimi i refugjatëve, thoshte: "Jam krenar që jam pjesë e një historie në të bërë."

Ndihma nuk vinte vetëm nga strukturat amerikane. Hebrej-amerikanët, të frymzurar nga historia e shpëtimit të hebrejve në Shqipër, përmes librit "Shpëtimi në Shqipëri", sponsorizuan qindra familje kosovare.

Sandra Schmidt, një prej tyre, mori në kujdes Armendin dhe familjen e tij, duke i quajtur shqiptarët "kombi më fisnik në Evropë".

Fort Dix, ky kamp që po zbrazet, është simbol i rrugëtimit biblik të kosovarëve nga ferri në shpëtim. Aty ku fjalët e para të mësuara në anglisht ishin: "Thank you". Një falënderim i thellë dhe i ndershëm për Amerikën dhe NATO-n, që u bënë miku i popullit shqiptar në ditët më të vështira të historisë.

EPILOG

Edhe Albert Ajnshtajni ishte emigrant.

Në hyrje të njërit prej ambienteve të kampit në Fort Dix – baza ushtarake amerikane në New Jersey, ku në pranverën e vitit 1999 u strehuan mijëra shqiptarë të Kosovës – ishte vendosur një poster i madh, në një vend të dukshëm. Në të shfaqej portreti i Albert Ajnshtajnit dhe poshtë tij, një mbishkrim që të ndalte në vend:

> ***"Emigrantët nuk sjellin vetëm një dorë plaçka nga jeta e tyre e përditshme. Edhe Ajnshtajni ishte emigrant."***

Aty, në mes të dhembjes dhe pasigurisë, kjo fjali ndillte një reflektim të thellë. Ajo të kujtonte historinë që shqiptarët e pështpërisnin me krenari: se Albert Ajnshtajni, duke i shpëtuar Holokaustit, kaloi përmes Shqipërisë, ku u prit nga Mbreti Zog, u pajis me pasaportë shqiptare dhe më pas mori vizën amerikane që e çoi në Princeton – këtu, në të njëjtin shtet të New Jersey-t ku edhe ne ishim mbledhur, gjysmë shekulli më vonë.
Ajnshtajni ishte emigrant. I përndjekur. I shpëtuar. Dhe i pranuar.
Dhe ai, si çdo shpirt i lirë që gjen strehë, i dha Amerikës më shumë sesa ajo kishte pritur.

Kur lexon këtë mesazh në kamp, përballë rreshtave të gjatë të çadrave dhe fytyrave të lodhura që sillnin me vete dhembjen, por edhe dinjitetin, mendja të shkon tek një tjetër galeri e shqiptarëve që kanë jetuar në dhe të huaj e që i dhanë kulturës sonë dritë: Noli, Konica, Naimi, Çajupi, Pashko Vasa, Shiroka...

Sot, të tjerë shqiptarë, të vegjël dhe të mëdhenj, të përndjekur e të shpërngulur, qëndronin në këtë kamp. Jo për të ndërtuar teorinë e relativitetit, por për të mbijetuar. E megjithatë, si Ajnshtajni, edhe ata ishin dëshmitarë të një kohe të padrejtë… dhe bartës të një shprese që nuk vdes.

Mal Berisha
Fort Dix, Korrik 1999